




# Doracak trajnimi mbi votimin dhe numërimin 2007



Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës

Zgjedhjet për Kuvendet Komunale

Zgjedhjet për Kryetarë të Komunave

Të nderuar,  
Kryesues dhe anëtarë të Këshillave të vendvotimeve

Kemi kënaqësinë që ju do të merrni pjesë në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, për Kuvendet Komunale dhe për Kryetar të Komunave që do të mbahen më 17 Nëntor të vitit 2007.

Është hera e parë që tri palë zgjedhje mbahen në të njëjtën ditë dhe shpresojmë se këtë do ta konsideroni si përvojë mjaft sfiduese dhe të dobishme.

Kontributi i juaj do të jetë njëri nga më të rëndësishmit në ditën e zgjedhjeve, meqë prania e juaj është parkusht që këto zgjedhje të zhvillohen në përputhje me standardet ndërkombëtare. Pjesmarrja e juaj është kontribut i rëndësishëm për realizimin e qëllimit të përgjithshëm në ndërtimin e institucioneve demokratike dhe për të mirën e të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka organizuar Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës në vitin 2004 me përkrahje të Misionit të OSBE-së në Kosovë. Për dallim nga zgjedhjet e mbajtura deri më tash, këto zgjedhje janë të parat që do të organizohen nga Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Roli i Misionit të OSBE-së në Kosovë në këto zgjedhje, kësaj here do të jetë vetëm këshillues dhe monitorues.

Dita e zgjedhjeve është njëra nga ditët më të rëndësishme në kalendarin e zgjedhjeve në Kosovës. Roli i juaj si anëtarë i këshillave të vendvotimeve është që të gjithë votuesve me zotësi juridike t'iu krijoni mundësi për të votuar dhe që rezultatet e zgjedhjeve të pasqyrojnë vullnetin e votuesve. Prania e juaj në vendvotime do të krijojë bindjen e të gjithë qytetarëve në Kosovë se Rregulloret dhe Rregullat në fuqi, do të zbatohen plotësisht në mënyrë të paanshme e transparente, duke ngritur kështu shkallën e besimit në procesin zgjedhor dhe duke siguruar legjitimitetin e rezultateve.

Ne e presim me përzemërsi angazhimin dhe përkushtimin tuaj në këto zgjedhje dhe njëkohësisht ju falënderojmë për kontributin tuaj të rëndësishëm në mbarëvajtjen e procesit Zgjedhor në Kosovë.

Me respekt,

Dr. Mazllum Baraliu

Kryeshf Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së





# PASQYRA E LËNDËS

	FUMRI I FAQEVE
<b>LETRA E MIRËSEARDHJES</b>	<b>1</b>
<b>PASQYRA E LËNDËS</b>	<b>3</b>
<b>I. SISTEMI I ZGJEDHJEVE NË VITIN 2007</b>	<b>5</b>
OBLIGIMET SI ANËTAR I KËSHILLIT TË VENDVOTIMIT	5
QENDRAT E VOTIMIT DHE VENDVOTIMET	6
<b>II. AKTIVITETET PARA DITËS SË ZGJEDHJEVE</b>	<b>7</b>
PRANIMI I MATERIALIT TË NDJESHËM DHE JO TË NDJESHËM	7
PËRGATITJA RREGULLIMI I VENDVOTIMIT	8
<b>III. PËRGATITJET NË MËNGJESIN E ZGJEDHJEVE</b>	<b>9</b>
ARRITJA NË QENDRAT E VOTIMIT	9
PËRGATITJET PËRFUNDIMTARE TË VENDVOTIMIT	9
<b>IV. ZHVILLIMI I VOTIMIT</b>	<b>10</b>
PERSONELI I AUTORIZUAR	10
VOTUESIT QË KANË NEVOJË PËR NDIHMË	11
KOMISIONI I ZGJEDHJEVE PËR ANKESA DHE PARASHTRESA	11
PROCEDURAT NË VENDVOTIM TË RREGULLT	12
PROCEDURAT NË VENDVOTIM TË DYFISHTË	13
<b>V. PËRFUNDIMI I VOTIMIT</b>	<b>15</b>
MBYLLJA E QENDRËS SË VOTIMIT	15
MBYLLJA E VENDVOTIMIT NË KUADËR TË QENDRËS SË VOTIMIT	15
DORËZIMI NGA KRYESUESI I EKIPIT TË VOTIMIT TE KRYESUESI I EKIPIT TË NUMËRIMIT	15
<b>VI. LISTA E GJËRAVE QË DUHET TË KRYHEN</b>	<b>16</b>
KRYESUESI I EKIPIT TË VOTIMIT	16
KONTROLLUESI I RRESHTIT	17
ZYRTARI I IDENTIFIKIMIT	18
DHËNËSI I FLETËVOTIMEVE	19
MBIKËQYRËSI I KUTISË SË VOTIMIT	20
KRYESUESI I EKIPIT TË VOTIMIT: PËRFUNDIMI I VOTIMIT DHE DORËZIMI	21
<b>VII. NUMËRIMI I FLETËVOTIMEVE</b>	<b>23</b>
NUMËRIMI I ZARFEVE TË FLETËVOTIMIMEVE ME KUSHT VETËM NË VENDVOTIMET E DYFISHTA	24
NUMËRIMI NË VOTIMIN ME FLETËVOTIME TË RREGULLTA	25
NUMËRIMI, KLASIFIKIMI DHE LLOGARITJA E FLETËVOTIMEVE PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË KOSOVËS	31
KLASIFIKIMI DHE NUMËRIMI I FLETËVOTIMEVE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDET KOMUNALE	32
KLASIFIKIMI DHE NUMËRIMI I FLETËVOTIMEVE PËR ZGJEDHJET PËR KRYETARË TË KOMUNAVE	33
PLOTËSIMI I FORMULARËVE TË PËRPUTHJES SË TË DHËNAVE DHE I REZULTATEVE DHE I FORMULARËVE TË REZULTATEVE TË KANDIDATËVE	35
<b>VIII. PAKETIMI DHE TRANSPORTIMI</b>	<b>36</b>
<b>IX. SHTOJCA</b>	<b>38</b>



# **SISTEMI I ZGJEDHJEVE NË VITIN 2007**

Më 17 Nëntor, njëkohësisht do të mbahen tri palë zgjedhje:

- Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës
- Zgjedhjet për Kuvendet Komunale
- Zgjedhjet për Kryetarë të Komunave

Elektorati do t'i zgjedh deputetët e Kuvendit të Kosovës, anëtarët e kuvendeve komunale dhe për herë të parë, do të zgjedh drejtpërdrejt kryetarin e komunës në secilën nga 30 komunat e Kosovës. Sipas rregulloreve, për Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës parashihet që Kosova të jetë një zonë e vetme zgjedhore, ndërsa për Zgjedhjet Komunale secila nga 30 komunat ekzistuese do të jetë zonë zgjedhore e veçantë. Për subjektet politike të komunitetit shumicë do të përdoret pragu zgjedhor prej 5%, ndërsa njëkohësisht do të mbahet kuota gjinore prej 30% për deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe ata të Kuvendeve Komunale.

Listat e hapura do të përdoren për të dy palë zgjedhjet: Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës dhe Zgjedhjet për Kuvendet Komunale, duke u dhënë mundësi votuesve që të përzgjedhin partinë e tyre të parapëlqyer, përveç se do të zgjedhin deri në dhjetë kandidatë nga lista e përzgjedhur e kandidatëve të subjektit politik.

Përveç tjerash, për Zgjedhjet për Kryetarë të Komunave mund të paraqitet nevoja për një raund të dytë të zgjedhjeve, nëse një kandidat nuk e fiton shumicën e votave gjatë raundit të parë.

Po ashtu, për votuesit me të drejtë vote është vënë në dispozicion një program për Votim Përmes Postës, ashtu që ata t'i dërgojnë votat e tyre me postë nga jashtë Kosovës.

## **OBLIGIMET SI ANËTAR I KËSHILLIT TË VENDVOTIMIT**

Si anëtar i këshillit të vendvotimit (KVV), ju jeni njëri ndër ata pak zyrtarë të zgjedhjeve me të cilët shumica e votuesve do të kenë kontakt të drejtpërdrejtë gjatë rrjedhës së këtyre zgjedhjeve. Prandaj, ka rëndësi shumë të madhe që të ruani nivelin më të lartë të profesionalizmit dhe të integritetit gjatë përmbushjes së detyrave tuaja, duke u shërbyer votuesve të Kosovës. Kjo përfshin detyrat tuaja parazgjedhore, siç janë: vijimi i trajnimit dhe përgjegjësitë tuaja në Ditën e Zgjedhjeve, gjatë numërimit të fletëvotimeve dhe raportimit të rezultateve të vendvotimit.

Me sjelljen juaj duhet të sigurohet saktësia e votës, si dhe integriteti, siguria, transparencja dhe qetësia e procesit të zgjedhjeve. Kjo do të ndihmojë në ndërtimin e një niveli të qëndrueshëm të besimit në sistemin e zgjedhjeve.

## **MIRËSJELLJA E RËNDOMTË KUR U OFROHET SHËRBIM VOTUESVE**

Gjithmonë ofrojuni shërbime me mirësjellje, përzemërsi, durim dhe dashamirësi të gjithë votuesve dhe vëzhguesve të akredituar. Kur u ofroni shërbim votuesve me aftësi të kufizuara, kushtojuni kohën e nevojshme që t'u shpjegoni procesin e votimit dhe drejtoni te personi përgjegjës që t'u ndihmojë atyre.

## **KODI I SJELLJES PËR ANËTARËT E KVV-SË**

Të gjithë anëtarët e KVV-së janë të obliguar të nënshkruajnë Kodin e Sjelljes për anëtarët e KVV-së.

## QENDRAT E VOTIMIT DHE VENDVOTIMET

**Qendra e votimit (QV)** është ndërtesë në të cilën janë të vendosura një ose më shumë vendvotime (VV). Qendra e votimit përfshin edhe hapësirën brenda 100 metrash që e rrethon ndërtesën, në shumicën e rasteve, ndërtesat që përdoren si qendra të votimit janë shkollat ose objektet e bashkësisë.

**Vendvotimi (VV)** është dhoma, salla ose objekti i ngjashëm i caktuar në QV ku do të zhvillohet votimi. Zakonisht vendvotimet janë klasë të shkollave. Në çdo vendvotim do të caktohen deri në 750 votues. Vendvotimi i fundit në çdo qendër të votimit është **vendvotim i dyfishtë**, ku mund të votohet me fletëvotime të rregullta dhe me ato me kusht.

## UDHËHEQJA E QENDRËS SË VOTIMIT DHE E VENDVOTIMIT

**Menaxheri i qendrës së votimit është përgjegjës për organizimin dhe planifikimin e të gjitha aktiviteteve në qendrën e votimit, jashtë vendvotimeve.**

**Këshilli i vendvotimit (KVV)** përbëhet nga zyrtarë të zgjedhjeve që e udhëheqin vendvotimin gjatë zgjedhjeve. Dy ekipe do të udhëheqin punën rreth zgjedhjeve në një vendvotim, njëri për votimin, ndërsa tjetri për numërimin e votave pas mbylljes së vendvotimit. **Kryesuesi i ekipit të votimit** (kryesuesi i EV-së) është përgjegjës për të gjitha aktivitetet në vendvotimin e tij/saj deri sa të bëhet dorëzimi te kryesuesi i ekipit të numërimit. **Kryesuesi i ekipit të numërimit** (kryesuesi i EN-së) është përgjegjës për të gjitha aktivitetet në vendvotimin e tij/saj gjatë procesit të numërimit dhe të paketimit.

## TAVOLINA NDIHMËSE

Në përgjithësi, qendrat e votimit do të kenë nga një tavolinë ndihmëse për t'u ofruar ndihmesë votuesve, të cilët kanë ardhur në qendrën e gabuar të votimit, që nuk mund të gjenden në Listën përfundimtare të votuesve (LPV), ose që nuk kanë dokumente të pranueshme të identifikimit. Personeli i tavolinës ndihmëse i përcjellë votuesit për te Lista e votuesve të komunës (LVeK) në mënyrë që votuesit të drejtohen për te qendra votimit ku janë caktuar.

## ANËTARËT E KËSHILLIT TË VENDVOTIMIT – EKIPI I VOTIMIT DHE EKIPI I NUMËRIMIT

Shumica e **ekipeve të votimit (EV)** përbëhen prej pesë anëtarëve, të udhëhequr nga kryesuesi i EV-së. Anëtarët e tjerë të ekipit të votimit janë: **kontrolluesi i rreshtit (KRr)**, **zyrtari i identifikimit (Zyrtari i ID)**, **dhënësi i fletëvotimit (DhF)** dhe **mbikëqyrësi i kutisë së votimit (MKV)**.

**Ekipi i numërimit (EN)** përbëhet prej pesë anëtarëve, të udhëhequr nga **kryesuesi i EN-së**. Anëtarët e tjerë kryejnë detyra që lidhen me numërimin, siç u caktohen nga kryesuesi i EN-së.

## AKRONIMET E ZGJEDHJEVE TË PËRDORURA NË KËTË DORACAK:

K. e votimit	Kuti e votimit
MKV	Mbikëqyrësi i kutisë së votimit
DhF	Dhënësi i fletëvotimeve
FK	Fletëvotim me kusht
ZFK	Zarf i fletëvotimit me kusht
FPR	Formular i rezultateve të kandidatit
EN	Ekipi i numërimit
Kryesues i EN-së	Kryesuesi i ekipit të numërimit
FLIK	Fletë llogaritëse për kandidatin
LVK	Lista e votuesve me kusht
KZAP	Komisioni i Zgjedhjeve për Ankesa dhe Parashtresa
ZI	Zyrtari i identifikimit
LPV	Lista përfundimtare e votuesve
KKZ	Komisioni komunal i zgjedhjeve
LVeK	Lista e votuesve të komunës
QV	Qendra e votimit
SP	Subjekti politik
EV	Ekipi i votimit
Kryesues i EV-së	Kryesuesi i ekipit të votimit
VV	Vendvotimi
KVV	Këshilli i vendvotimit
KRr	Kontrolluesi i rreshtit
FPR	Formulari i përputhjes së të dhënave dhe rezultateve

## **II. AKTIVITETET PARA DITËS SË ZGJEDHEJVE**

### **PLANIFIKIMI PARAPRAK NGA KRYESUESI I EKIPIT TË VOTIMIT**

Kryesuesi i EV-së është përgjegjës për funksionimin e tërësishëm të vendvotimit gjatë orëve të votimit. Para zgjedhjeve, nga kryesuesi i ekipit të votimit dhe anëtarët e tjerë të ekipit të votimit duhet të kryhen një sërë punësh përgatitore, në mënyrë që procesi i votimit në Ditën e Zgjedhjeve të jetë efektiv dhe efikas.

### **PRANIMI I MATERIALIT TË NDJESHËM DHE JO TË NDJESHËM**

Materiali i ndjeshëm dhe jo i ndjeshëm do të arrijë në qendrën e votimit një ditë para Ditës së Zgjedhjeve. Materiali i ndjeshëm do të ruhet gjatë natës në QV në një vend të sigurt. Me materialin jo të ndjeshëm do të ngritet vendvotimi.

#### **Materiali i ndjeshëm**

Material i ndjeshëm janë ata artikuj që janë shumë të rëndësishëm për votimin, numërimin dhe raportimin e rezultateve.

#### **Material i ndjeshëm:**

- Fletëvotimet për të tri palë zgjedhjet (Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, Zgjedhjet Komunale, Zgjedhjet për Kryetar të Komunave)
- Lista përfundimtare e votuesve
- Lista e votuesve me kusht (që përdoret në vendvotimet e dyfishtë)
- Vula zyrtare e fletëvotimit
- Broshurat e kandidatëve për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës
- Broshurat e kandidatëve për zgjedhjet për Kuvendet Komunale

#### **Materiali jo i ndjeshëm:**

- Llamba ultravjollcë (Llamba UV)
- Ngjyra e padukshme
- Libri i votimit
- Formulari i përputhjes së të dhënave dhe të rezultateve (FPR)
- Formulari i rezultateve të kandidatit (FRK)
- Ngjyra dhe mbushësit e ngjyrës
- Kabinat e votimit
- Kutitë e votimit
- Shiritat mbyllës të sigurisë
- Formularët e ankesave të KZAP-it
- Fletët llogaritëse të kandidatit
- Zarfet e fletëvotimeve me kusht (**Vetëm për vendvotimet e dyfishta**)
- Zarfet e fshehtësisë (**Vetëm për vendvotimet e dyfishta**)
- Lista e votuesve të komunës (**Vetëm për vendvotime të caktuara - t'i dorëzohet menaxherit të QV-së**)
- Artikuj të ndryshëm të materialit për zyrë (shenja, lapsa, letër, etj.)

Të gjithë anëtarët e ekipit të votimit (EV) janë përgjegjës për përgatitjen dhe rregullimin e vendvotimit. Kjo detyrë duhet të kryhet një ditë para Ditës së Zgjedhjeve. Çdo rregullim i ri i dhomës që mund të jetë i nevojshëm para se të fillojë votimi, nuk duhet ta vonojë hapjen e vendvotimit deri në orën 07.00 të Ditës së Zgjedhjeve. Asnjë lloj materiali i fushatës së zgjedhjeve nuk lejohet në VV.

### **PËRGATITJET NË VENDVOTIM**

Një ditë para zgjedhjeve, materiali jo i ndjeshëm që gjendet në kutinë e votimit duhet të shpaketohet. Artikujt e shpaktuar duhet të kontrollohen një nga një duke i krahasuar me Listën për kontrollimin e materialeve. Të gjitha llambat dhe bateritë duhet të testohen. Mos pritni deri në Ditën e Zgjedhjeve! Për çdo material që mungon duhet t'i raportoni menjëherë personit për kontaktim të komisionit komunal të zgjedhjeve (KKZ), në mënyrë që VV-ja të mund të furnizohet sërish para fillimit të votimit.



## PËRGATITJA DHE RREGULLIMI I VENDVOTIMIT

Vendvotimi duhet të organizohet për të mundësuar qarkullim sa më efikas të votuesve gjatë gjithë ditës:

- Ulëset duhet të rregullohen në atë mënyrë që anëtarët e EV-së, vëzhguesit e zgjedhjeve dhe përfaqësuesit e akredituar të mediave të mund ta shikojnë tërë procesin e votimit dhe ta shohin qartë kutinë e votimit gjatë gjithë kohës.
- Tavolinat duhet të vendosen në atë mënyrë që të gjithë anëtarët e EV-së mund t'i shohin votuesit duke hyrë në vendvotim dhe që votuesve me pengesa në lëvizje t'u mundësohet hapësirë e mjaftueshme për kalim të lehtë.
- Kabinat e votimit duhet të vendosen në atë mënyrë që të sigurohet që votuesi të mund të votojë në fshhtësi. Mund të jetë i nevojshëm mbulimi i dritareve.


Mënyra e organizimit të VV-së varet nga madhësia dhe trajta e dhomës, vendndodhja e dyerve të hyrjes dhe të daljes. Proveni konfiguracione të ndryshme derisa ta gjeni ndonjë që funksionon.

### Vendosja e shenjave dhe e njoftimeve

Njoftimet e mëposhtme duhet të ekspozohen kryesisht brenda dhe jashtë vendvotimit:

- Listat alfabetike me të cilat votuesit caktohen në një vendvotim të veçantë (në hyrje të VV-së)
- Posterët me Listën e kandidatëve për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe zgjedhjet për Kuvendet Komunale (jashtë VV-së)
- Posterët "Si të shënohet fletëvotimi" (Prapa kabinave të votimit dhe jashtë VV-ve)
- Broshurat e kandidatëve (prapa kabinave të votimit dhe mbi tavolinën e dhënësit të fletëvotimeve)
- Shenjat e shigjetave për orientim (brenda VV-së)
- Shenjat për "ndalimin e pirjes së duhanit" (jashtë VV-së)
- Shenjat për "ndalimin e armëve" (jashtë VV-së)

**Pasi VV-ja** të jetë përgatitur dhe rregulluar dhe të jenë kontrolluar të gjitha materialet, kryesuesi i EV-së duhet të sigurohet se anëtarët e EV-së i kanë kuptuar qartë procedurat e Ditës së Zgjedhjeve.



### **III. PËRGATITJET NË MËNGJESIN E DITËS SË ZGJEDHJEVE**

#### **ARRITJA NË QENDRAT E VOTIMIT**

Çdo anëtar i EV-së duhet të arrijë në VV-në e tij/saj ku është caktuar deri në orën 06:00. Nëse mungon ndonjëri nga anëtarët e EV-së, kryesuesi i EV-së duhet të kërkojë anëtarë rezervë nga KKZ-ja. Me të arritur në QV, kryesuesi EV-së e merr çdo material që është ruajtur gjatë natës nga menaxheri i QV-së.

#### **PËRGATITJET PËRFUNDIMTARE TË VOTIMIT**

Kryesuesi i EV-së duhet të vërtetojë se të gjithë anëtarët e EV-së i kanë kuptuar mirë detyrat e veta. Kryesuesi i EV-së duhet të sigurojë që kabinat e votimit dhe tavolinat e punës të jenë të organizuara në atë mënyrë që të lehtësojnë qarkullimin e rregullt të votuesve. Rregullimi i tavolinave dhe drejtimi i rrjedhës së qarkullimit duhet të planifikohet një ditë përpara. Të gjitha shenjat duhet të jenë të vendosura. Nëse ka pasur vështirësi për hyrjen në atë vend, ose puna nuk ka mundur të kryhet, rregullimi i vendvotimit duhet të bëhet me kohë në mëngjes, në Ditën e Zgjedhjeve, në mënyrë që votimi të fillojë në orën 07.00.

#### **KONTROLLIMI I PAJISJEVE DHE PAKETIMI I ZARFEVE**

Anëtarët e EV-së duhet të gjejnë një vend të sigurt për t'i vendosur të gjitha pajisjet dhe materialet dhe të sigurohen se i kanë të gjitha pajisjet, zarfet për paketim dhe artikujt e tjerë siç janë: stilolapsat, lapsat, llambat etj., që mund t'ju nevojiten gjatë ditës.

Nëse mungon ndonjë artikull, duhet të njoftohet menaxheri i QV-së në mënyrë që të sillen furnizimet e nevojshme në VV. Anëtarët e EV-së NUK DUHET të largohen nga QV-ja për të marrë furnizime!

#### **PARA SE TË VOTOJË VOTUESI I PARË**

Para se të fillojë votimi, duhet të ndërmerren hapat e mëposhtëm nën vëzhgimin e plotë të vëzhguesve të zgjedhjeve dhe të përfaqësuesve të akredituar të mediave:

- Duhet të plotësohet pjesa I e fletës së punës së formularit të përputhjes së të dhënave dhe të rezultateve (FPR) për secilën nga tri palë zgjedhjet. *Shih mostrat e FPR-së në shtojcë.*
- Kryesuesi i EV-së duhet t'i ekspozojë kutitë e zbrazëta të votimit (nga një për secilën palë zgjedhje) para të gjithë të pranishmëve dhe pastaj i mbyll të gjitha anët e kutive të votimit me shiritat mbyllës të sigurisë. Shiritat mbyllës duhet të shtrëngohen mirë, në mënyrë që pjesa e sipërme e kutisë të mbahet sigurt për kutinë e votimit, pa asnjë zbrazëtitë përgjatë skajeve. Duhet të bëhet e pamundur futja e çfarëdo materiali aty, përveç përmes vrimës në pjesën e sipërme.
- Kryesuesi i EV-së ose i caktuari i tij/saj do t'i regjistrojë numrat e shiritave mbyllës në fletat e punës të FPR-së për secilën nga tri palë zgjedhjet.

Pasi të jenë realizuar hapat e përmendur më lart, kryesuesi i EV-së shpall hapjen e vendvotimit. Kryesuesi i EV-së i shënon në librin e votimit emrat, numrat e letërnjoftimeve dhe numrat e akreditimit të të gjithë personelit të ekipit të votimit dhe të vëzhguesve të pranishëm, si dhe kohën e hapjes së vendvotimit.

## **IV. ZHVILLIMI I VOTIMIT**

**TË GJITHA VENDVOTIMET HAPEN NË ORËN 07:00 DHE MBYLLEN NË ORËN 19:00  
TË SHTUNËN, MË 17 NËNTOR 2007**

### **PERSONELI I AUTORIZUAR**

**Personat në vijim janë të autorizuar të jenë të pranishëm në qendër të votimit/vendvotim në Ditën e Zgjedhjeve:**

- Votuesit
- Anëtarët e ekipit të votimit dhe personeli i qendrës së votimit;
- Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- Personeli i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- Anëtarët e komisionit komunal të zgjedhjeve
- Anëtarët e personelit të UNMIK-ut dhe të OSBE-së në detyrë zyrtare me përkthyes, nëse ka nevojë
- Vëzhguesit e zgjedhjeve me përkthyes, nëse ka nevojë
- Përfaqësuesit e mediave të akredituara me përkthyes, nëse ka nevojë
- Policia në detyrë zyrtare, kur thirret për të rivendosur rendin.

### **VËZHguesIT DHE MEDIAT**

Vëzhguesit e zgjedhjeve dhe përfaqësuesit e akredituar të mediave janë shumë të rëndësishëm për vlerësimin dhe raportimin e transparencës dhe të legjitimitetit të zgjedhjeve, dhe duhet të mirëprehen, e jo të shihen si barrë. Ata duhet t'u përmbahen rregullave të caktuara në mënyrë që votuesi të mund të votojë në fshehtësi dhe ata nuk duhet ta pengojnë procesin e zgjedhjeve. Brenda një vendvotimi gjatë kohë së njëjtë nuk mund të jenë më shumë se dy vëzhgues nga një organizatë e njëjtë e akredituar. Nëse kryesuesi i EV-së mendon se numri i vëzhguesve të zgjedhjeve ose i përfaqësuesve të akredituar të mediave po e pengon procesin e votimit brenda vendvotimit, ai/ajo duhet t'i udhëzojë ata që ta zvogëlojnë numrin e tyre, si dhe do të ndërmarrë hapa të tjerë për të ruajtur funksionimin e papenguar të procesit të votimit. Vëzhguesit dhe përfaqësuesit e mediave duhet t'i ekspozojnë distinktivët e tyre dhe të gjitha kartelat e akreditimit gjatë gjithë kohës, gjersa janë brenda QV-së/VV-së.

### **VËZHguesIT E ZGJEDHJEVE MUND TË:**

- jenë të pranishëm dhe nga afër të vëzhgojnë në tërësi procesin e votimit dhe të numërimit (me përjashtim të shënimit të fletëvotimit nga votuesi), përderisa nuk e pengojnë procesin e zgjedhjeve ose përderisa nuk marrin nëpër dorë ose kufizojnë shfrytëzimin e ndonjë materiali të vendvotimit;
- pasi të ketë filluar procesi i numërimit, vëzhguesit mund të largohen nga vendvotimi, por nuk mund të kthehen dhe të hyjnë më aty pas fillimit të numërimit;
- paraqesin te kryesuesi i EV-së/EN-së të gjitha preokupimet e tyre, por jo te anëtarët e tjerë të këshillit. Kryesuesi i EV-së/EN-së do t'u drejtohet anëtarëve të këshillit drejtpërdrejt për çfarëdo çështje që ata mund të shtrojnë.

### **PËRFAQËSUESIT E AKREDITUAR TË MEDIAVE MUND TË:**

- vëzhgojnë procesin e votimit (me përjashtim të shënimit të fletëvotimit nga votuesi), përderisa nuk e pengojnë procesin e zgjedhjeve ose përderisa nuk e kufizojnë shfrytëzimin e ndonjë materiali të vendvotimit;
- filmojnë brenda qendrës së votimit/vendvotimit përderisa nuk incizojnë asnjë informatë personale të ndonjë votuesi ose përderisa nuk e shkelin fshehtësinë e votuesve (nuk lejohet filmimi i LPV-së/LVK dhe shënimi i fletëvotimit nga votuesi);
- filmojnë lëvizjen e votuesit nëpër qendër të votimit/vendvotim, me lejen e votuesit.
- zhvillojnë intervista me votuesit (pas votimit të tyre) jashtë rrezes prej 100 metrash që e rrethon qendrën e votimit dhe me lejen e votuesit;

## **VOTIMI I ANËTARËVE TË EKIPIT TË VOTIMIT**

Anëtari i EV-së i cili nuk punon në QV-në në të cilin ai ose ajo është në LPV, do të votojë me kusht në VV-në e dyfishtë të qendrës së tij/saj të votimit. Anëtari i EV-së duhet t'i jepet kohë që të votojë atëherë kur ka më pak gjasa për ndërprerjen e punës së tij/saj në VV-në ku ai/ajo punon. Kryesuesi i EV-së duhet të përkujdeset që në vendvotim gjatë një kohe të caktuar të mungojë vetëm nga një anëtar.

## **VOTUESIT QË KËRKOJNË NDIHMË**

Votuesi me aftësi të kufizuara mund të kërkojë nga kryesuesi i EV-së që të lejojë dikë që t'i ndihmojë atij/asaj në shënimin e fletëvotimit të vet. Ndhmësi i zgjedhur nga votuesi nuk është e thënë që të jetë votues i regjistruar dhe nuk mund të jetë anëtar i këshillit të vendvotimit, vëzhgues i akredituar apo përfaqësues i akredituar i mediave. Votuesi që kërkon ndihmë mund të ketë vetëm një ndihmës i cili mund ta shoqërojë votuesin prapa kabinës së votimit. Nëse votuesi i cili ka nevojë për ndihmë është analfabet ai/ajo do ta vëjë një shenjë pranë emrit të tij/saj në LPV dhe zyrtari i identifikimit do të vëjë inicialet e veta brenda rubrikës së nënshkrimit për të treguar se shenja është bërë në prani të dëshmitarit. Kryesuesi i EV-së do të mbikëqyrë njerëzit të cilët japin ndihmë për të siguruar që një ndihmës të mos ndihmojë shumë votues gjatë asaj dite. Ndhmësi gjithashtu mund të votojë, nëse ka zotësi juridike, para ose pasi ta ketë ndihmuar votuesin (por jo gjatë dhënies së ndihmës). Kryesuesi i EV-së do ta dekurajojë "votimin familjar", duke e përdorur gjykimin e vet të lirë kur anëtarët e familjes vijnë për të votuar.

## **LIBRI I VOTIMIT**

Vetëm kryesuesit të ekipit të votimit dhe të ekipit të numërimit, anëtarëve të ekipit të votimit dhe të ekipit të numërimit dhe vëzhguesve të akredituar u lejohej të bëjnë shënime në librin e votimit. Nëse votuesi ka ndonjë ankesë përkitazi me ndonjë aktivitet në kuadër të VV-së, ai/ajo mund të kërkojë nga kryesuesi t'i regjistrojë ankesat e votuesve në librin e votimit. Përveç kësaj, votuesi mund të paraqesë ankesë në Komisionin e Zgjedhjeve për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP).

## **KOMISIONI I ZGJEDHJEVE PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**

Nëse votuesi ka ndonjë ankesë përkitazi me cilindo aspekt të procesit të votimit, përfshirë këtu përjashtimin nga LPV-ja, kryesuesi i EV-së do ta informojë atë për të drejtën e tij/saj për të parashtruar ankesë në Komisionin e Zgjedhjeve për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP) dhe do t'ia sigurojë atij/asaj formularin e ankesës të KZAP-it. Për këtë qëllim, në kompletin e pajisjeve të VV-së janë të përfshira edhe kopjet e formularit të ankesës të KZAP-it.

As kryesuesi i EV-së, e as anëtarët e EV-së nuk duhet t'i ndihmojnë votuesit që ta plotësojnë formularin e KZAP-it (përveç nëse ai/ajo kërkon ndihmë) dhe nuk duhet ta pranojnë formularin e plotësuar. Votuesi duhet të informohet se ai/ajo mund ta dorëzojë formularin personalisht, me faks, ose me postë në zyrën e KZAP-it në Selinë Qendrore të UNMIK-ut në Prishtinë, dhe personalisht në recepcionin e çdo zyre të OSBE-së. Për çdo çështje lidhur me votimin dhe numërimin, ankesat duhet të merren brenda 24 orëve pasi parashtruesi i ankesës të jetë vënë në dijeni për problemin e supozuar, por gjithsesi jo më vonë se 48 orë pasi të ketë ndodhur shkelja e supozuar. Ky afat i fundit do të zbatohet me rreptësi, për shkak të nevojës që KZAP-i t'i shqyrtojë dhe vendosë shpejt për të gjitha ankesat që mund të ndikojnë në rezultatet e zgjedhjeve.

### **KZAP**

Adresa e përkohshme, Zyra e Shefit të Stafit

Selia e UNMIK-ut

10 000 Prishtinë

Telefoni: +381 38 504 604 4408

Faksi: +381 38 504 604 4266

Emaili: ecac@un.org

## PROCEDURAT NË VENDVOTIM TË RREGULLT

### PËRCAKTIMI I ZOTËSISË JURIDIKE (PËR VOTIM) TË VOTUESIT TË RREGULLT:

Që të votojë, votuesi duhet të ketë së paku 18 vjet, të ketë kryer regjistrimin civil dhe të dëshmojë identitetin e vet.

- A ka votuesi dokument të pranueshëm të identifikimit? Dokumentet e pranueshme të identifikimit janë vetëm këto:
  - Letërnjoftimi personal valid i UNMIK-ut.
  - Dokumenti valid i udhëtimit i UNMIK-ut;
  - Patentë shoferi valid i UNMIK-ut;
  - Kartela valide e PZhBV-së, ose kartela valide e refugjatit.

Nëse nuk paraqitet asnjëri nga këto dokumente, votuesit i refuzohet dhënia e fletëvotimit. Shih Shtojcën për mostrat e dokumenteve.

- A i ka votuesi së paku 18 vjeç? Nëse jo, atëherë votuesit i refuzohet dhënia e fletëvotimit.
- A figuron emri i votuesit në Listën përfundimtare të votuesve të atij vendvotimi? Nëse jo, atëherë për ndihmë të mëtejshme votuesi do të drejtohet për te tavolina ndihmëse e qendrës së votimit.

### ARSYET E TJERA PSE VOTUESIT TË RREGULLT I REFUZOHET DHËNIA E FLETËVOTIMIT:

- Votuesi paraqitet në vendvotim dhe në gishtat e votuesit është evidente prania e ngjyrës së padukshme.
- Votuesi refuzon t'i spërkatet gishti me ngjyrë të padukshme.
- Votuesi refuzon të nënshkruajë në Listën përfundimtare të votuesve (LPV).

### FAZA 1 – KONTROLLUESI I RRESHTIT (Votimi me fletëvotim të rregullt)



Kontrolluesi i rreshtit (KRr) vendoset në hyrje të vendvotimit dhe është përgjegjës për mbarëvajtjen e rreshtit të votuesve. Kontrolluesi i rreshtit do t'i lejojë votuesit me aftësi të kufizuara të dalin në fillim të rreshtit. Përveç kësaj, kontrolluesi i rreshtit, me lejen e kryesuesit të EV-së do t'i lejojë policët e SHPK-së me uniformë dhe në detyrë zyrtare; si dhe anëtarët nga ekipet e tjera të votimit të dalin në fillim të rreshtit. Kontrolluesi i rreshtit do të kërkojë nga votuesit në rresht dokumentet e pranueshme të identifikimit. Nëse votuesi është në vendvotimin e gabuar, për ndihmë të mëtejshme kontrolluesi i rreshtit do ta drejtojë votuesin te tavolina ndihmëse. Përveç kësaj, kontrolluesi i rreshtit do t'i kontrollojë gishtat e çdo votuesi me llambë ultravjollcë; nëse votuesi refuzon t'i kontrollohen gishtat ose ka dëshmi

të pranisë së ngjyrës së padukshme në gishtat e vet, atëherë kontrolluesi i rreshtit do të kërkojë nga votuesi që të largohet nga vendvotimi. Pastaj kontrolluesi i rreshtit do ta njoftojë kryesuesin e EV-së, i cili do ta shënojë rastin në librin e votimit. Nëse nuk ka dëshmi të ngjyrës së padukshme në gishtat e votuesit, kontrolluesi i rreshtit do ta drejtojë votuesin te zyrtari i identifikimit.

### FAZA 2 – ZYRTARI I IDENTIFIKIMIT (Votimi me fletëvotim të rregullt)

Zyrtari i identifikimit (ZI) e verifikon identitetin e votuesit dhe konstaton nëse votuesi ka zotësi juridike për të votuar në atë VV, duke gjetur emrin e votuesit në LPV, duke përdorur dokumentin e identifikimit të votuesit. Nëse votuesi nuk paraqet dokument të pranueshëm të identifikimit, nga votuesi do të kërkohet që ai/ajo të largohet nga vendvotimi. Nëse votuesi nuk mund të gjendet në LPV-në e vendvotimit, për ndihmë të mëtejshme zyrtari i identifikimit do ta drejtojë votuesin te tavolina ndihmëse.

Nëse votuesi ka zotësi juridike për të votuar me fletëvotim të rregullt, zyrtari i identifikimit do të kërkojë nga votuesi që të nënshkruajë në LPV. Nëse votuesi është analfabet dhe nuk është në gjendje të nënshkruajë në LPV, ai/ajo mund të vë një shenjë pranë emrit të tij/saj në LPV, ndërsa zyrtari i identifikimit do të vëjë inicialet e veta brenda rubrikës së nënshkrimit për të treguar se shenja është bërë në prani të dëshmitarit. Nëse votuesi refuzon të nënshkruajë ose të vë shenjën e vet, votuesit do t'i refuzohet dhënia e fletëvotimit dhe nga ai/ajo do të kërkohet që të largohet nga vendvotimi. Pasi votuesi të nënshkruajë ose të vëjë shenjën e vet në LPV, zyrtari i identifikimit do ta drejtojë atë te dhënësi i fletëvotimeve.



### **FAZA 3 – DHËNËSI I FLETËVOTIMEVE (Votimi me fletëvotim të rregullt)**



Dhënësi i fletëvotimeve (DhF) është përgjegjës për shpërndarjen e fletëvotimeve dhe që të kujdeset për fletëvotimet e papërdorura dhe të dëmtuara. Saherë që dhënësi i fletëvotimeve e hap pakon e fletëvotimeve, ai/ajo do t'i numërojë ato dhe do të kontrollojë nëse mungon ndonjë fletëvotim ose nëse ka më shumë se 50 fletëvotime në një bllok. Dhënësi i fletëvotimeve i raporton kryesuesit të EV-së për çfarëdo parregullsie. Dhënësi i fletëvotimeve ia spërkat me ngjyrë të padukshme gishtin e djathtë tregues votuesit. Nëse votuesi refuzon t'i spërkatet gishti, votuesit nuk do t'i jepet fletëvotimi dhe nga ai do të kërkohet që të largohet nga vendvotimi. Pastaj, dhënësi i fletëvotimeve do ta informojë kryesuesin e EV-së, i cili do ta shënojë rastin në librin e votimit dhe tërheq një vijë në nënshkrimin e tij/saj në LPV. Deri sa ngjyra e padukshme të thahet, dhënësi i fletëvotimeve do të palos dhe vulos anën e prapme të fletëvotimit me vulën zyrtare të fletëvotimit. Dhënësi i fletëvotimeve e udhëzon me kujdes votuesin se si ta shënojë fletëvotimin duke iu referuar broshurave të kandidatëve. Dhënësi i fletëvotimeve pastaj i shpjegon sesi të paloset fletëvotimi dhe i tregon votuesit se çka duhet të bëjë nëse e dëmton fletëvotimin. Dhënësi i fletëvotimeve e drejton votuesin te një kabinë e lirë e votimit që ta shënojë fletëvotimin në fshehtësi. Dhënësi i fletëvotimeve do ta shënojë çdo fletëvotim të dëmtuar duke shkruar “i dëmtuar” në anën e prapme të tij dhe e mban atë në një zarf të caktuar enkas për këtë qëllim.

### **FAZA 4 – MBIKËQYRËSI I KUTISË SË VOTIMIT (Votimi me fletëvotim të rregullt)**

Mbikëqyrësi i kutisë së votimit (MKV) është përgjegjës për ruajtjen e kutive të votimit për të parandaluar ndërhyrjen dhe vjedhjen, dhe për kontrollimin e kabinave të votimit për të siguruar se në të njëjtën kohë voton vetëm një votues. MKV-ja qëndron afër kutive të votimit dhe i shikon mirë kabinat e votimit. MKV-ja rregullisht do t'i kontrollojë kabinat e votimit për t'u siguruar se ka laps dhe të kontrollojë se broshurat e kandidatëve janë në gjendje të rregullt. Çdo shkrim i papërshtatshëm në kabinat e votimit do të mbulohet, në rast të ndonjë ndërhyrje në broshurat e kandidatëve, ato do të zëvendësohen me ekzemplarë të rinj. Në fund, MKV-ja do të përkujdeset që çdo votues të vendosë fletëvotimin e vet në kutinë përkatëse të votimit dhe pas kësaj do ta drejtojë votuesin kah dalja e vendvotimit.



### **PROCEDURAT NË VENDVOTIM TË DYFISHTË**

Në disa raste, votuesi mund të mos figurojë në LPV-në e VV-së në të cilën ai/ajo është caktuar. Nëse ndodh kështu, atëherë votuesi do të drejtohet te tavolina ndihmëse. Nëse votuesi ka dokument të pranueshëm të identifikimit, por nuk mund të gjendet në LVMK, ai/ajo do të drejtohet te vendvotimi i dyfishtë që të votojë me fletëvotim me kusht. Po ashtu, votuesi duhet të votojë me kusht nëse ka ndonjë “shenjë” në LPV pranë emrit të tij/saj në LPV, që tregon se votuesi duhet të votojë me fletëvotim me kusht.

### **PËRCAKTIMI I ZOTËSISË JURIDIKE I VOTUESIT QË VOTON ME FLETËVOTIM ME KUSHT**

Që të votojë me kusht, votuesi duhet të ketë së paku 18 vjet, të ketë kryer regjistrimin civil dhe të dëshmojë identitetin e vet.

- A i ka votuesi së paku 18 vjeç? Nëse jo, atëherë votuesit do t'i refuzohet dhënia e fletëvotimit.
- A ka votuesi dokument të pranueshëm të identifikimit? Nëse jo, atëherë votuesit do t'i refuzohet dhënia e fletëvotimit.

### **ARSYET TJERA PSE VOTUESIT ME KUSHT I REFUZOHET DHËNIA E FLETËVOTIMIT**

- Votuesi paraqitet në vendvotim të dyfishtë dhe në gishtat e votuesit është evidente prania e ngjyrës së padukshme.
- Votuesi refuzon të nënshkruajë në Listën e votuesve me kusht (LVK).
- Votuesi refuzon të nënshkruajë deklaratën në zarfin e fletëvotimit me kusht (ZFK) me të cilën konfirmon se informatat e dhëna janë të vërteta dhe se ai/ajo nuk ka tentuar dhe nuk do të tentojë të votojë në asnjë mënyrë tjetër në këto zgjedhje.
- Votuesi refuzon t'i spërkatet gishti me ngjyrë të padukshme.

## **FAZA 1 – KONTROLLUESI I RRESHTIT (Votimi me fletëvotim me kusht)**

Kontrolluesi i rreshtit ndërmerr hapat e njëjtë për votuesit me kusht sikurse për votuesit që votojnë me fletëvotim të rregullt.

## **FAZA 2 – ZYRTARI I IDENTIFIKIMIT (Votimi me fletëvotim me kusht)**

### **Hapat shtesë:**

Zyrtari i identifikimit do të përcaktojë nëse votuesi ka zotësi juridike për të votuar me fletëvotim me kusht në bazë të dokumentit të paraqitur të identifikimit. Pa dokument të pranueshëm të identifikimit, votuesi nuk mund të votojë me fletëvotim me kusht. Zyrtari i identifikimit do t'i shënojë të dhënat e votuesit në rreshtin e parë të papërdorur që ka në dispozicion në Listën e votuesve me kusht (LVK) duke i përdorur dokumentet e tij/saj të identifikimit për të shënuar emrin dhe mbiemrin me SHKRONJA TË MËDHA TË SHTYPIT (saktësisht siç paraqiten në dokumentin e identifikimit), si dhe datën e tij/saj të lindjes dhe numrin e regjistrimit, nëse ky i fundit është në dispozicion. Nëse votuesi nuk e di numrin e vet të regjistrimit, zyrtari i identifikimit do të tërheqë një vijë në atë hapësirë dhe e informon votuesin se nëse ai/ajo nuk është i/e regjistruar, atëherë fletëvotimi nuk do t'i numërohet. Nëse votuesi refuzon të nënshkruajë në LVK, ai/ajo nuk mund të votojë dhe duhet të largohet nga vendvotimi.

Zyrtari i identifikimit do të plotësojë ZFK-në dhe dhënësit të fletëvotimeve ia jep dokumentin e identifikimit të votuesit dhe ZFK-në e plotësuar, dhe votuesin e drejton për te dhënësi i fletëvotimeve.

## **FAZA 3 – DHËNËSI I FLETËVOTIMEVE (Votimi me fletëvotim me kusht)**

### **Hapat shtesë:**

Dhënësi i fletëvotimeve e merë ZFK-në e plotësuar dhe dokumentin e identifikimit të votuesit nga zyrtari i identifikimit, do t'ia spërkat votuesit gishtin e djathtë tregues me ngjyrë të padukshme, e palos dhe e vulos anën e prapme të fletëvotimit duke zbatuar procedurat e njëjta si të votuesit që votojnë me fletëvotim të rregullt.

Dhënësi i fletëvotimeve ia jep votuesit dy zarfe të fshehtësisë. Në njërin që ka shenjën me ngjyrë të kuqe duhet të vendoset fletëvotimi për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës. Në të dytin që ka shenja me ngjyrë të kaltër dhe të verdhë duhet të vendosen fletëvotimet për Zgjedhjet për Kuvendin Komunal dhe për Zgjedhjet për Kryetar të Komunës.

Pasi t'ia jep votuesit fletëvotimet dhe zarfet e fshehtësisë, dhënësi i fletëvotimeve do ta drejtojë votuesin te një kabinë e lirë e votimit që t'i shënojë fletëvotimet në fshehtësi. Në ndërkohë, dhënësi i fletëvotimeve, ZFK-në e plotësuar dhe dokumentin e identifikimit të votuesit ia dorëzon mbikëqyrësit të kutisë së votimit (MKV).

## **FAZA 4 – MBIKËQYRËSI I KUTISË SË VOTIMIT (Votimi me fletëvotim me kusht)**

### **Hapat shtesë:**

Mbikëqyrësi i kutisë së votimit i përcjell me vëmendje votuesit prapa kabinave të votimit dhe dokumentet e identifikimit të votuesve, të cilat është duke i mbajtur. Kur votuesi me kusht del nga kabina e votimit, MKV-ja do ta shikojë nga afër për t'u siguruar që ai/ajo të mos i hedhë thjesht zarfet e tij/saj të fshehtësisë në kutinë e votimit të fletëvotimeve me kusht. Nëse fletëvotimet nuk janë palosur siç duhet, MKV-ja e udhëzon votuesin se palosja duhet të bëhet në fshehtësi prapa kabinës së votimit.

MKV-ja do të kontrollojë dokumentin e identifikimit të votuesit për të vërtetuar se atij/asaj i është dhënë ZFK-ja e saktë, me qëllim që votuesi të mund t'i vendosë zarfet e veta të fshehtësisë brenda ZFK-së së tij/saj të kompletuar. Votuesi e mbyll ZFK-në në prani të MKV-së dhe e vendos atë në kutinë e votimit. Nëse është e nevojshme, MKV-ja i ndihmon votuesit që ta palosë ZFK-në e mbyllur, por duhet që votuesi ZFK-në e mbyllur ta vendosë vet në kutinë e votimit.

Nëse votuesi, fletëvotimet ose zarfin e tij/saj të fshehtësisë e vendos drejtpërdrejt në kutinë e votimit pa ZFK, MKV-ja do ta informojë kryesuesin e KVV-së, i cili do ta shënojë rastin në librin e votimit. Pastaj, MKV-ja do të kërkojë nga votuesi që ZFK-në e zbrazët ta vendosë në kutinë e votimit, do t'ia kthejë dokumentin e identifikimit votuesit dhe do të kërkojë nga votuesi që të largohet nga vendvotimi.

## **V. PËRFUNDIMI I VOTIMIT**

### **MBYLLJA E QENDRËS SË VOTIMIT**

Në orën 19:00, menaxheri i qendrës së votimit do të përkujdeset që asnjë votues tjetër të mos hyjë në rreshtat e QV-së. Të gjitha VV-të në kuadër të QV-së do të mbeten të hapura derisa të kenë votuar, votuesit në të gjithë rreshtat e tjerë në kuadër të qendrës së njëjtë të votimit, në mënyrë që çdo person që vjen në qendër të votimit para orës 19.00 të lejohet të votojë. Kjo i jep mundësinë për të votuar, votuesit i cili është në rresht të gabuar.

### **MBYLLJA E VENDVOTIMIT NË KUADËR TË QENDRËS SË VOTIMIT**

Kryesuesi i EV-së e mbyll derën e vendvotimit pasi të jetë informuar nga menaxheri i qendrës së votimit ose i caktuari i tij/saj se edhe votuesi i fundit në qendrën e votimit është larguar.

Pasi të shpallet mbyllja e vendvotimit, kryesuesi i EV-së menjëherë do të mbyllë vrimat e kutive të votimit me shiritat e sigurisë dhe numrat e shiritave do t'i shënojë në fletën e punës të FPR-së, ndërkaq kohën e saktë të mbylljes do ta shënojë në librin e votimit.

### **DORËZIMI I PËRGJEGJËSIVE NGA KRYESUESI I EKIPIT TË VOTIMIT TE KRYESUESI I EKIPIT TË NUMËRIMIT**

Jo më vonë se një orë para përfundimit të votimit, kryesuesi i ekipit të numërimit së bashku me një anëtar të ekipit të numërimit do të arrijë në vendvotim për të monitoruar mbylljen e vendvotimit para dorëzimit të ekipi i numërimit.

Për të plotësuar pjesën II të FPR-së, kryesuesi i ekipit të votimit do ta delegojë detyrën e numërimit të fletëvotimeve të dëmtuara dhe të papërdorura. Përveç kësaj, do të numërohen edhe nënshkrimet e votuesve në LPV dhe në LVK, nëse vendvotimi është i dyfishtë. Të gjitha këto numërime duhet të vërtetohen me një numërim të dytë nga një anëtar tjetër i ekipit të votimit, për të siguruar saktësinë e rezultatit. Nuk lejohet ASNJË mospërputhje gjatë numërimeve të lartpërmendura!

Të gjitha rezultatet do të shënohen në pjesën II të secilit nga të tre FPR-të origjinale, kryesuesi i ekipit të votimit dhe kryesuesi i ekipit të numërimit do të nënshkruajnë dorëzim - pranimin dhe secili anëtar i ekipit të votimit do të nënshkruajë në hapësirën e paraparë në fund të formularëve. Materiali i numëruar pakëtohet në thasët dhe zarfet gjegjëse pa i mbyllur. Pastaj, përgjegjësitë për vendvotimin do të dorëzohen nga kryesuesi i ekipit të votimit te kryesuesi i ekipit të numërimit. Pasi të kryhet dorëzimi dhe pasi të jetë nënshkruar formulari, ekipi i numërimit i merr përsipër përgjegjësitë dhe mund të vazhdojë me numërim.



## VI. LISTA E GJËRAVE QË DUHET TË KRYHEN

### LISTA E GJËRAVE QË DUHET TË KRYHEN NGA KRYESUESI I EKIPIT TË VOTIMIT

- Është përgjegjës për të gjitha operacionet brenda vendvotimit deri sa të bëhet dorëzimi te kryesuesi i ekipit të numërimit. Ai/ajo siguron zbatimin e të gjitha rregullave të zgjedhjeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe monitoron çfarëdo parregullsie.
- Në rast të shkeljes së ndonjë rregulle të KQZ-së, kryesuesi i EV-së e shënon atë shkelje në librin e votimit të VV-së dhe e njofton komisionin komunal të zgjedhjeve (KKZ).
- E cakton zëvendësin në rast të mungesës së tij/saj.
- U cakton detyrat të gjithë anëtarëve të ekipit të votimit (anëtarëve të EV-së).
- Është përgjegjës për mbajtjen e qetësisë dhe të rregullit në vendvotim (VV).
- Merret me mediat, vëzhguesit e akredituar dhe personelin e sigurisë (përgjegjësi ekskluzive e tij/saj).
- Për çështje procedurale, kryesuesi i EV-së kontakton me trajnerët e Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (SKQZ), ndërsa për çështje operative kryesuesi i EV-së kontakton me KKZ-në.
- U cakton detyra të gjithë anëtarëve të ekipit të votimit për t'i ndihmuar atij/asaj në kryerjen e detyrave të renditura më poshtë.

#### Detyrat e kryesuesit të EV-së para hapjes së votimit

**E plotëson pjesën I** të formularit të përputhjes së të dhënave dhe rezultateve (FPR) për secilën palë zgjedhje.  
**U shpërndan** anëtarëve të EV-së materialin e zgjedhjeve (të ndjeshëm dhe jo të ndjeshëm).  
**Etiketoni** zarfet, thasët dhe formularët që do të përdoren në vendvotim gjatë Ditës së Zgjedhjeve.  
**Siguron** përgatitjen dhe rregullimin adekuat të vendvotimit.  
**Eksponon** kutitë e zbrazëta të votimit para të gjithë personave të pranishëm në vendvotim.  
**I mbyll** dhe i vendos ato në vendin ku shihen plotësisht nga të gjithë të pranishmit në vendvotim.  
**Shënon** numrat e shiritave mbyllës të sigurisë të kutive të votimit në formularin e përputhjes së dhënave dhe rezultateve (FPR) për secilën palë zgjedhje.

#### Detyrat e kryesuesit të EV-së gjatë zhvillimit të votimit


**Shënon** kohën e hapjes dhe emrat e anëtarëve të EV-së.  
**Shënon** emrat dhe numrat e DI-ve të akreditimit të vëzhguesve të pranishëm.  
**Mbikëqyr** zhvillimin e procedurave të votimit në vendvotim në përputhje me Rregullat e zgjedhjeve.  
**Siguron** që të gjithë formularët e nevojshëm të jenë në vendvotim dhe të plotësohen në mënyrë të saktë.

#### Detyrat e kryesuesit të EV-së gjatë mbylljes së votimit

**Mbyll** derën e vendvotimit pasi të jetë informuar nga menaxheri i qendrës së votimit se edhe votuesi i fundit në qendrën e votimit ka votuar.  
**Cakton** një anëtar të EV-së që të qëndrojë te dera dhe t'i monitorojë të gjithë personat që hyjnë në vendvotim dhe që largohen nga vendvotimi.  
**Menjëherë** mbyll vrimat e të tri kutive të votimit.  
**Shënon** në fletët e punës të FPR-ve numrat e shiritave mbyllës të sigurisë që përdoren për mbylljen e vrimave të kutive të votimit.  
**Shënon** në librin e votimit kohën e mbylljes së vendvotimit dhe emrat e vëzhguesve të akredituar të pranishëm.  
**Mbikëqyr** mbylljen e vendvotimit dhe procesin e përputhjes së materialit para se ai/ajo t'ia dorëzojë përgjegjësitë mbi vendvotimin, kryesuesit të ekipit të numërimit.  
**Është përgjegjës** për plotësimin e FPR-ve ose për delegimin e kësaj detyre te ndonjë anëtar tjetër i EV-së.  
**E plotëson pjesën II** të formularit të përputhjes së të dhënave dhe rezultateve (FPR) për secilën palë zgjedhje dhe përkujdeset që ai të nënshkruhet edhe nga anëtarët e tjerë të EV-së.  
**Dorëzon** tërë materialin te kryesuesi i ekipit të numërimit.

## LISTA E GJËRAVE QË DUHET TË KRZHEN NGA KONTROLLUESI I RRESHTIT

- ☑ Qëndron në hyrje të vendvotimit.
- ☑ Siguron qarkullim të kontrolluar të votuesve brenda vendvotimit.
- ☑ I udhëzon votuesit që të përgatisin dokumentet e identifikimit (DI-të) para se të hyjnë në vendvotim. Dokumentet e pranueshme të identifikimit janë: letërnjoftimi personal i UNMIK-ut, dokumenti i udhëtimit i UNMIK-ut, patentë shoferi i UNMIK-ut, kartela valide e PZhBV-së dhe kartela valide e refugjatit.
- ☑ Kontrollon duart/gishtat e secilit votues me llambën ultravjollcë (UV) për të parë nëse ka prani të ngjyrës së padukshme.
- ☑ I drejton votuesit për te zyrtari i identifikimit.
- ☑ Kontrollon nëse votuesi është në VV-në e saktë që përputhet me rendin alfabetik.
- ☑ I drejton votuesit për te tavolina ndihmëse, nëse ata janë në VV të gabuar.
- ☑ U kushton vëmendje të veçantë votuesve që kanë nevojë për ndihmë, siç janë: gratë shtatzëna, votuesit e moshuar dhe policët e SHPK-së në uniformë dhe në detyrë zyrtare, si dhe anëtarët e ekipit të votimit, duke i lejuar ata që të dalin në fillim të rreshtit.
- ☑ I drejton për në DALJE nga QV-ja - votuesit që tashmë kanë votuar.




# LISTA E GJËRAVE QË DUHET TË KRYHEN NGA ZYRTARI I IDENTIFIKIMIT

## NË VENDVOTIMIN E RREGULLT:

- Verifikon identitetin e votuesit duke kërkuar nga votuesi që të paraqesë dokumentin e tij/saj të identifikimit. Dokumentet e pranueshme të identifikimit janë vetëm këto si vijon: letërnjoftimi personal i UNMIK-ut, dokumenti i udhëtimit i UNMIK-ut, patentë shoferi i UNMIK-ut, kartela valide e PZhBV-së dhe kartela valide e refugjatit.
- E gjen emrin e votuesit në Listën përfundimtare të votuesve (LPV).
- Kërkon nga votuesit që të nënshkruajnë pranë emrit të tyre në LPV.
- Udhëzon votuesit që kërkojnë ndihmë që të vëjnë një shenjë pranë emrit të tyre në LPV dhe të vëjnë inicialet e veta brenda rubrikës së nënshkrimit për të treguar se shenja është bërë në prani të dëshmitarit.
- I drejton votuesit te dhënësi i fletëvotimeve.
  - Nëse votuesi nuk gjendet në LPV, e as në LVMK, por ka zotësi juridike për të votuar, ose
  - Nëse votuesi gjendet në LPV dhe pranë emrit të tij/saj në LPV është një “shenjë”, që tregon se votuesi duhet të votojë me kusht, atëherë **votuesi do të votojë me kusht në një vendvotim të dyfishtë.**

## NË VENDVOTIM TË DYFISHTË (votimi me kusht)

- Verifikon identitetin e votuesit duke kërkuar nga ai/ajo që të paraqesë dokumentin e identifikimit.
- Shënon të dhënat e votuesit në Listën e votuesve me kusht (LVK) me SHKRONJA TË MËDHA TË SHTYPIT, duke përdorur dokumentin e pranueshëm të identifikimit të votuesit.
- Kërkon nga votuesi që të nënshkruajë pranë emrit të tij në LVK.
- Udhëzon votuesit që kërkojnë ndihmë që të vëjnë një shenjë paranë emrit të tyre në LVK dhe të vëjnë inicialet e veta brenda rubrikës së nënshkrimit për të treguar se shenja është bërë në prani të dëshmitarit.
- Plotëson zarfin e fletëvotimit me kusht (ZFK) me SHKRONJA TË MËDHA TË SHTYPIT dhe kërkon nga votuesi që ta nënshkruajë atë.
- Ia dorëzon dokumentin e identifikimit të votuesit dhe ZFK-në e kompletuar, dhënësit të fletëvotimeve (DhV).
- E drejton votuesin te dhënësi i fletëvotimeve



# LISTA E GJËRAVE QË DUHET TË KRYHEN NGA DHËNËSI I FLETËVOTIMEVE


Dhënësi i fletëvotimeve (DhF) është përgjegjës për mbajtjen e fletëvotimeve në gjendje të rregullt në VV. Pasi të pranohen fletëvotimet nga DhF-ja, atëherë është përgjegjësi e tij/saj që të kontrollojë, numërojë dhe të informojë kryesuesin e EV-së nëse ka ndonjë fletëvotim të dëmtuar ose me gabime shtypi.

## NË VENDVOTIMIN E RREGULLT:

- ☑ SPËRKATË gishtin e djathtë tregues të votuesit me ngjyrë të padukshme.
- ☑ Shkëput vetëm një fletëvotim njëherësh nga amat e fletëvotimit (të gjitha amat e përdorura të fletëvotimeve duhet të ruhen me kujdes gjatë votimit).
- ☑ PALOSË dhe VULOSEË pjesën e prapme të tri fletëvotimeve (një fletëvotim për secilën palë zgjedhje) dhe ia JEP fletëvotimet votuesit.
- ☑ E udhëzon me kujdes votuesin se si t'i shënojë fletëvotimet dhe si t'i shfrytëzojë broshurat e kandidatëve.
- ☑ E drejton votuesin te kabina e votimit.
- ☑ Nëse votuesi e dëmton fletëvotimin, DhF-ja do ta shkruaj "i dëmtuar" në pjesën e prapme të fletëvotimit, e vendos atë në zarfin 1 "fletëvotimet e dëmtuara" për zgjedhjet përkatëse dhe ia jep votuesit një fletëvotim tjetër të vulosur për ato zgjedhje të caktuara.

## NË VENDVOTIM TË DYFISHTË (Votuesi me kusht)

- ☑ Në vendvotimet e dyfishta, DhF-ja përveç tri fletëvotimeve të vulosura, do t'i jep edhe dy zarfe të fshehtësisë. Në zarfin me shenjë të kuqe duhet të vendoset fletëvotimi për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës. Në zarfet me shenjë të kaltër dhe të verdhë duhet të vendosen dy fletëvotime, për Zgjedhjet për kuvendet komunale dhe për Zgjedhjet për kryetarë të komunave.
- ☑ E udhëzon votuesin që të mos i mbyllë zarfet e fshehtësisë para se të shkojë te kutia e votimit në mënyrë që mbikëqyrësi i kutisë së votimit të sigurohet se votuesi i ka vendosur fletëvotimet në zarfet përkatëse.
- ☑ Ia dorëzon mbikëqyrësit të kutisë së votimit dokumentin e identifikimit të votuesit dhe ZFK-në e kompletuar.



# LISTA E GJËRAVE QË DUHET TË KRYHEN NGA MBIKQYRËSI I KUTISË SË VOTIMIT

## NË VENDVOTIMIN E RREGULLT


- Mbikëqyrë kutitë e votimit (KV) për të parandaluar ndërhyrjen dhe vjedhjen.
- Siguron që votuesit të votojnë një nga një me radhë.
- Siguron që secili votues t'i hedhë fletëvotimet e tij/saj në kutinë përkatëse të votimit.
- I drejton votuesit për në DALJE nga vendvotimi pasi të kenë votuar.
- Rregullisht i kontrollon kabinat e votimit për të siguruar që stilolapsi të jetë në dispozicion aty dhe që broshurat e kandidatëve të jenë në gjendje të rregullt.
- Çfarëdo shkrimi i papërshtatshëm në kabinat e votimit do të mbulohet, ndërsa broshurat e manipuluar të kandidatëve do të zëvendësohen.

## NË VENDVOTIM TË DYFISHTË (Votimi me fletëvotim me kusht)

### Detyrat shitesë:

- Merr nga dhënësi i fletëvotimeve dokumentin e identifikimit të votuesit dhe ZFK-në.
- Kontrollon dokumentin e identifikimit të votuesit për të vërtetuar që atij/asaj i është dhënë ZFK-ja e saktë.
- Siguron që votuesi me kusht të mos i hedh thjesht fletëvotimet në kutitë e votimit pa i vendosur fletëvotimet në zarfet përkatëse të fshehtësisë dhe pastaj në zarfet e votimit me kusht.
- Kontrollon nëse votuesi i ka vendosur fletëvotimet në zarfet e sakta të ngjyrosura të fshehtësisë:
  - E kuqe për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës
  - E kaltër dhe e verdhë për Zgjedhjet për kuvendet komunale dhe Zgjedhjet për kryetarë të komunave.
- Kërkon nga votuesi që t'i mbyllë zarfet e fshehtësisë.
- I dorëzon votuesit ZFK-të e plotësuar në mënyrë që ai/ajo të mund t'i vendosë zarfet e fshehtësisë në ZFK-të përkatëse, kërkon nga votuesi t'i mbyllë zarfet dhe t'i vendosë ato në kutinë e votimit me kusht.

Nëse votuesi, fletëvotimin ose zarfin e tij/saj të fshehtësisë e vendos drejtpërdrejt në kutinë e votimit pa ZFK, MKV-ja do ta informojë kryesuesin e EV-së, i cili do ta shënojë rastin në librin e votimit. Pastaj, MKV-ja do të kërkojë nga votuesi që ZFK-në e zbrazët ta vendosë në kutinë e votimit të fletëvotimeve me kusht, do t'ia kthejë dokumentin e identifikimit votuesit dhe e drejton atë për në dalje të vendvotimit.



## **LISTA E GJËRAVE QË DUHET TË KRYHEN NGA KRYESUESI I EKIPIT TË VOTIMIT MBYLLJA E VOTIMIT DHE DORËZIMI**

### **MBYLLJA E VENDVOTIMIT NË KUADËR TË QENDRËS SË VOTIMIT**

Kryesuesi i EV-së ose i anëtari i EV-së i caktuar nga ai/ajo, e mbyll derën e vendvotimit pasi të jetë informuar nga menaxheri i qendrës së votimit ose i caktuari i tij/saj se edhe votuesi i fundit është larguar nga qendra e votimit.

Kryesuesi i EV-së do t'i caktojë anëtarët e EV-së për të kryer detyrat e mëposhtme:

- Që menjëherë të mbyllen vrimat e të gjitha kutive të votimit.
- Shënon në librin e votimit kohën e mbylljes së vendvotimit, numrat shiritave mbyllës me të cilët janë mbyllur vrimat e kutive të votimit dhe emrat e personave të pranishëm në vendvotim.
- Shënon në fletët e punës të FPR-ve për tri palë zgjedhjet e ndryshme, numrat e shiritave mbyllës të sigurisë që janë përdorur për mbylljen e vrimave të tri kutive të votimit.
- Qëndron te dera dhe i monitoron të gjithë personat që hyjnë në vendvotim dhe që largohen nga vendvotimi.

### **NUMËRIMI I FLETËVOTIMEVE TË DËMTUARA DHE TË PAPËRDORURA**

Kryesuesi i EV-së do t'i angazhojë anëtarët e këshillit për t'i kryer këto detyra:

- Numërohen fletëvotimet e dëmtuara për tri palë zgjedhjet (njërën pas tjetrës) dhe shënohet sasia në fletët e punës të FPR-ve përkatëse. **NUMËROHEN PËR TË DYTËN HERË NGA ANËTARI I DYTË I EKIPIT TË VOTIMIT – NË KËTË FAZË NUK LEJOHET ASNJË MOSPËRPUTHJE!**
- Palosen dy herë fletëvotimet e dëmtuara dhe përmbi to vendoset një shënim që tregon numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve. Të gjitha këto vendosen në zarfin 1 dhe në të shënohet sasia e fletëvotimeve.
- Numërohen fletëvotimet e papërdorura për të tri palë zgjedhjet ndaras dhe shënohet sasia në fletët e punës të tre FPR-ve të dedikuara për tri palë zgjedhje të ndryshme. **NUMËROHEN PËR TË DYTËN HERË NGA ANËTARI I DYTË I EKIPIT TË VOTIMIT – NË KËTË FAZË NUK LEJOHET ASNJË MOSPËRPUTHJE!**
- Fletëvotimet e papërdorura paketohen së bashku me amat e fletëvotimeve për të tri palë zgjedhjet ndaras në thesin 2 (një thes për secilën palë zgjedhje – të mos mbyllen ende).
- Numërohen nënshkrimet e votuesve në LPV dhe në LVK, në rast të vendvotimit të dyfishtë dhe shënohen sasi të fletët gjegjëse të punës të tri FPR-ve. **NUMËROHEN PËR TË DYTËN HERË NGA ANËTARI I DYTË I EKIPIT TË VOTIMIT – NË KËTË FAZË NUK LEJOHET ASNJË MOSPËRPUTHJE!**

### **DORËZIMI I NGA KRYESUESI I EKIPIT TË VOTIMIT TE KRYESUESI I EKIPIT TË NUMËRIMIT**

Kryesuesi i ekipit të votimit do t'i dorëzojë materialet e paketuara vijuese hap pas hapi në këtë renditje:

- Një zarf (të zbrazët) i KKZ-së
- Vulën zyrtare të fletëvotimeve.
- Një zarf që përmban formularët e paplotësuar të ankesave.
- Tri (3) kuti të votimit për tri palë zgjedhjet përkatëse, ose katër (4) në rastet e vendvotimeve të dyfishta.
- Tri zarfe 1, të cilat do të mbyllen dhe sigurohen që në të shkruhet numri i vendvotimit.
- Tre (3) thasë 2 që përmbajnë fletëvotime të papërdorura dhe amat e fletëvotimit. Vetëm thesi 2 për Zgjedhjet për kryetarë të komunave **mbyllet** dhe në të shënohet kodi i vendvotimit.
- Tri (3) zarfe 3 (të zbrazëta).
- Tre (3) thasë 4 (të zbrazët).

- Një thes (i zbrazët) për zarfet e fletëvotimeve me kusht (vetëm në vendvotimet e dyfishta).
- Dy (2) formularë të rezultateve të kandidatëve: Për zgjedhjet për Kuvend të Kosovës dhe për Zgjedhjet për kuvendet komunale.
- Dy (2) dengje me fletë llogaritëse të kandidatëve: për zgjedhjet për Kuvend të Kosovës dhe për Zgjedhjet për kuvendet komunale.

Kryesuesi i ekipit të votimit, i shoqëruar nga kryesuesi i ekipit të numërimit i bart (kopjon) të gjitha të dhënat nga Pjesa I dhe II të fletës së punës të FPR-së në FPR-në origjinale për secilën palë zgjedhje.

Pastaj, të dy kryesuesit nënshkruajnë në pjesën e dorëzimit në FPR-të origjinale. Secili anëtar i ekipit të votimit do të nënshkruajë në hapësirën e dhënë në fund të formularëve. Kryesuesi i EN-së tani i merr nën kujdesin e tij FPR-të e të tri (3) palë zgjedhjeve.

Pasi të kryhet dorëzimi dhe të jenë nënshkruar FPR-të, ekipi i votimit mund të largohet, ndërsa ekipi i numërimit nën mbikëqyrjen e kryesuesit të ekipit të numërimit mund të vazhdojë me numërimin.

## **FALEMINDERIT EKIPI TË VOTIMIT**

## **ME FAT EKIPI TË NUMËRIMIT**

## VII. NUMËRIMI I FLETËVOTIMEVE

### **PËRGATITJET PËR NUMËRIM**

Kryesuesi i ekipit të numërimit i shënon në librin e votimit emrat, numrat e letërnjoftimeve dhe numrat e akreditimit të të gjithë vëzhguesve të akredituar që janë të pranishëm dhe i informon se nëse largohen nga VV-ja para se të përfundojë numërimi, ata nuk do të lejohen të kthehen.

Kryesuesi i ekipit të numërimit do t'u lejojë komisionit komunal të zgjedhjeve, Sekretariatit të KQZ-së, KQZ-së dhe personelit të zgjedhjeve të OSBE-së qasje të pakufizuar në VV gjatë procesit të numërimit për të ndihmuar në çfarëdo çështje që mund të paraqitet.

Detyrat që duhet të kryhen nga anëtarët e ekipit të numërimit (EN) para se të fillojë numërimi:

- Vendosni tavolinat në atë mënyrë që vëzhguesit e akredituar të mund të shohin qartë tërë procesin e numërimit.
- Përgatitni hapësirën e punës për numërim (hiqni nga tavolinat të gjithë stilolapsat, lapsat dhe materialet e tjera).
- Kryesuesi i ekipit të numërimit (kryesuesi i EN-së) u cakton anëtarëve të EN-së detyra përkitazi me numërimin.

Tërë materiali që i është dorëzuar kryesuesit të ekipit të numërimit largohet nga hapësira e përgatitur për numërim, por aty ku mund të shihet nga çdokush që është i pranishëm në vendvotim. Materiali duhet të ruhet dhe mbikëqyret në atë mënyrë që askush të mos mund të ndërhyjë asnjëherë në të, gjatë procesit të numërimit.

Kutitë e votimit duhet të hapen një nga një dhe të numërohen si më poshtë:

1. Votimi me kusht (**vetëm në vendvotim të dyfishtë**)
2. Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës
3. Zgjedhjet për kuvendet komunale
4. Zgjedhjet për kryetarë të komunave

**Në vendvotimin ku votohet vetëm me fletëvotime të rregullta, filloni me “Numërimi i fletëvotimeve për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës” (faqe 24).**

**Në vendvotimin e dyfishtë ku votohet me fletëvotime me kusht dhe me fletëvotime të rregullta, ndiqni procedurën e mëposhtme “Numërimi i zarfeve të fletëvotimeve me kusht në vendvotimet e dyfishta”.**



# NUMËRIMI I ZARFEVE TË FLETËVOTIMEVE ME KUSHT VETËM NË VENDVOTIMET E DYFISHTA

Para hapjes së kutisë së votimit me fletëvotime me kusht, një anëtar i ekipit të numërimit do të lexojë me zë të lartë të gjithë numrat e shiritave mbyllës të kutisë së votimit, ndërsa kryesuesi i EN-së do t'i konfirmojë numrat me të dhënat e shënuara më herët në FPR (rubrika 2d dhe rubrika 4d).

Kryesuesi i EN-së do t'i presë shiritat në pjesët anësore të kutisë së fletëvotimeve me kusht dhe materialin që ndodhet në kuti e zbraz mbi tavolinë, ashtu që të mund të shihet plotësisht nga të gjithë anëtarët e EN-së dhe vëzhguesit e akredituar. Kutia e votimit duhet të mbetet e mbyllur.

Do të numërohen vetëm zarfet e fletëvotimeve me kusht (ZFK-të), ndërsa zarfet nuk do të hapen në VV. ZFK-të do të numërohen dy herë nga anëtarë të ndryshëm të EN-së për të siguruar që numri i gjithmbarshëm i ZFK-ve përputhet. Nëse numri i gjithmbarshëm i ZFK-ve nuk përputhet, anëtarët e EN-së do t'i rinumërojnë deri sa numri i njëjtë i gjithmbarshëm të arrihet dy herë radhazi.

**Nëse në kutinë e votimit me kusht gjenden fletëvotime të pangjitura, zarfe të fshehtësisë dhe/ose ZFK të zbrazëta, ato shënohen në librin e votimit (artikulli dhe sasia), ndërsa ato vendosen në thesin e zarfeve të fletëvotimeve me kusht.**

Nëse në kutinë e votimit me kusht gjendet ZFK-ja e zbrazët, ajo do të numërohet sikurse ZFK-të e mbyllura si duhet.

Të gjitha ZFK-të (të mbyllura, të pambyllura ose të zbrazëta) numërohen dhe numri i përgjithshëm i tyre shënohet më rubrikën 8d të fletës së punës të FPR-së për zgjedhjet për Kuvend të Kosovës.

Numri i përgjithshëm i ZFK-ve në rubrikën (8d) duhet të përputhet me numrin e nënshkrimeve në Listën e votuesve me kusht në rubrikën (5d). Nëse nuk ndodh kështu, atëherë ndryshimi duhet të shënohet në rubrikën 9d të fletës së punës të FPR-së për zgjedhjet për Kuvend të Kosovës.

Të gjitha ZFK-të e numëruara vendosen në thesin për zarfet e fletëvotimeve me kusht. Mos e mbyllni thesin ende, por vendoseni mënjandë brenda vendvotimit nën mbikëqyrje të përhershme, ashtu që të mos mund të ndërhyhet në të.

# NUMËRIMI I FLETËVOTIMEVE TË RREGULLTA

## NUMËRIMI I FLETËVOTIMEVE PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË KOSOVËS

Para se të hapet kutia e votimit për zgjedhjet për Kuvend të Kosovës, një anëtar i ekipit të numërimit do t'i lexojë me zë të lartë të gjithë numrat e shiritave mbyllës të kutisë së votimit, ndërsa kryesuesi i EN-së do t'i krahasojë ata numra me të dhënat e shënuara më herët në FPR (rubrika 2 dhe rubrika 4).

Të gjithë anëtarët e ekipit të numërimit i zënë vendet rreth tavolinës së numërimit. Nën vëzhgimin e plotë të të gjithë anëtarëve të EN-së dhe të vëzhguesve të akredituar që janë të pranishëm, kryesuesi i EN-së do t'i presë shiritat mbyllës në pjesët anësore të kutisë së votimit të zgjedhjeve për Kuvend të Kosovës dhe materialin brenda kutisë e zbraz mbi tavolinë. Vrima e sipërme e kutisë së votimit do të mbetet e mbyllur.

Gjatë gjithë procesit të numërimit: **Të gjitha të dhënat duhet që së pari të shënohen në fletën e punës të secilit formular të përputhjes së të dhënave dhe rezultateve (FPR)**, para se ndonjë e dhënë të bartet në FPR-të origjinale. FPR-të origjinale duhet të plotësohen vetëm pasi të jetë kryer numërimi për të tri palë zgjedhjet. MBANI MEND: për secilën palë zgjedhje do të ketë nga një FPR.

## FAZAT E NUMËRIMIT PËR VOTIMIN ME FLETËVOTIME TË RREGULLTA, DUKE E PËRCJELLË RENDITJEN NË FPR

**1. Fletëvotimet shpalosen duke i vënë përmbys dhe ndahen në fletëvotime të vulosura dhe të pavulosura.**

**2. Fletëvotimet e vulosura dhe të pavulosura numërohen dy herë** (gjatë këtij procesi fletëvotimet e vulosura dhe të pavulosura mbahen ndaras). Formohen ekipe me nga 2 anëtarë të numërimit. Anëtar i parë e fillon numërimin duke bërë grumbuj me nga 25 fletëvotime, të cilat i përcillen anëtarit të dytë të numërimit. Nëse numërimi i anëtarit të dytë rezulton me numër të njëjtë sikurse i pari, atëherë vazhdohet me grumbullin tjetër të radhës. Nëse numërimi i anëtarit të dytë rezulton me një numër të ndryshëm nga ai i numëruesit të parë, atëherë grumbulli rinumërohet sërish deri sa shuma e përgjithshme të arrihet e njëjtë dy herë.

**3. Pasi të numërohen të gjithë grumbujt me fletëvotimet e vulosura dhe të pavulosura, shuma e përgjithshme shënohet në rubrikën 8 të fletës së punës të FPR-së.**

**4. Të gjitha fletëvotimet e pavulosura konsiderohen të pavlefshme dhe veçohen mënjanë mbi tavolinën e numërimit, aty ku mund të shihen plotësisht nga të gjithë të pranishmit në vendvotim. Mbi grumbullin e fletëvotimeve të pavulosura vendoset pusulla me ngjyrë të verdhë e cila tregon numrin e fletëvotimeve të pavulosura.**

**5. Kryesuesi i ekipit të numërimit e krahason numrin e përgjithshëm të nënshkrimeve në Listën përfundimtare të votuesve** tanimë dy herë të numëruara (rubrika 5), me **numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve** (rubrika 8) që janë gjetur në kutinë e votimit (përputhja në rubrikën 9). Nëse numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të numëruara është i barabartë me numrin e përgjithshëm të nënshkrimeve në LPV, në rubrikën 9 të fletës së punës së FPR-së shënohet 0, ndërsa procesi i numërimit vazhdon.

Nëse ka mospërputhje, pranohet toleranca e mospërputhjes si në vijim:

Deri në 100 nënshkrime në LPV	1 (-/+)
Deri në 200 nënshkrime në LPV	2 (-/+)
Më shumë se 200 nënshkrime në LPV	3 (-/+)

**Nëse mospërputhjet janë brenda këtyre niveleve, dallimi shënohet në rubrikën 9 dhe pastaj mund të fillojë klasifikimi i fletëvotimeve sipas subjektit politik.**

Nëse **dallimet janë më të mëdha se niveli i mospërputhjes**, atëherë **numërimi i fletëvotimeve të rregullta** duhet të **përsëritet**. Nëse mospërputhjet nuk mund të zgjidhen as pas rinumërimit të

fletëvotimeve, atëherë në **librin e votimit shënohet një VËREJTJE**, ku shpjegohet ajo situatë. **Mospërputhja do të vërehet gjatë verifikimit të përputhshmërisë në FPR (rubrika 9).**

**Si të vepohet me fletëvotimet që gjenden në kutinë e gabuar të votimit?**

Nëse ndonjë fletëvotim është vendosur në kuti të gabuar të votimit me fletëvotime të rregullta, ajo do të veçohet mënjane, dhe më vonë do të numërohet për zgjedhjet përkatëse.


**Si të vepohet me materialin e votimit me kusht që gjendet në kutinë e gabuar të votimit?**

Nëse ZFK-ja është vendosur gabimisht në kutinë e votimit të caktuar për votimin me fletëvotime të rregullta, atëherë në fund të numërimit ajo ZFK duhet të numërohet së bashku me ZFK-të nga kutia e votimit me kusht dhe shtohet në rubrikën 8d dhe 19 të fletës së punës të FPR-së për zgjedhjet për Kuvend të Kosovës. Gjithashtu, duhet të ndryshohet si duhet rubrika 19 në fletën e punës të FPR-së për Zgjedhjet për kuvendet komunale dhe të FPR-së për Zgjedhjet për kryetarë të komunave.

Nëse ndonjë zarf i pangjitur fshehtësisë ose ZFK gjendet në kuti të votimit për votim me fletëvotime të rregullta, numri i përgjithshëm i tyre shënohet në librin e votimit, ZFK-të numërohen së bashku me ZFK-të e gjetura në kutinë e votimit me kusht dhe ato vendosen në **thesin e zarfeve të fletëvotimeve me kusht**.

# KLASIFIKIMI I FLETËVOTIMEVE PËR ÇDO SUBJEKT POLITIK (SP)

Përgatiteni hapësirën e klasifikimit si në diagramin e mëposhtëm:



## Klasifikimi:

Kalohet në punë me grumbujt që kanë nga 25 fletëvotime, lexuesit i kthejnë fletëvotimet mbarë, dhe i tregojnë klasifikuesit të tyre gjegjëse se për cilin SP është shënuar fletëvotimi. Pastaj, klasifikuesi e vendos fletëvotimin në hapësirën e dhënë për atë SP. Procesi vazhdon deri sa të klasifikohen të gjitha fletëvotimet. Nëse lexuesi nuk është i sigurt për vlefshmërinë e fletëvotimit, atëherë ai fletëvotim i dorëzohet kryesuesit të EN-së, i cili do të vendosë për këtë.

Si të përcaktohet vlefshmëria e fletëvotimeve:

**Nëse qëllimi i votuesit është i qartë, fletëvotimi duhet të konsiderohet i vlefshëm.**


Fletëvotime të pavlefshme janë:

- Fletëvotimi pa shenjë për subjektin politik, por me shenjë vetëm për kandidatët
- Fletëvotimi ku është votuar për më shumë se një subjekt politik
- Fletëvotimi ku preferenca e votuesit për subjektin politik është e paqartë
- Fletëvotimi që nuk është i vulosur me vulën zyrtare të fletëvotimit

Vendimi i kryesuesit të EN-së është përfundimtar në atë vendvotim. Nëse ndonjë anëtar i ekipit të numërimit ose vëzhgues i akredituar nuk pajtohet me vlerësimin e kryesuesit të EN-së për një fletëvotim të caktuar, ai/ajo mund të paraqesë ankesë.

## NUMËRIMI I FLETËVOTIMEVE TË HEDHURA PËR ÇDO SUBJEKT POLITIK (SP)

Përgatitja dhe rregullimi i hapësirës mbetet i njëjtë. Ndryshimi i vetëm është se lexuesit dhe klasifikuesit tani do të numërojnë dy herë në çift.



Në tavolinën e numërimit sillen grumbulli i fletëvotimeve për SP-në e parë. Ekipi i numërimit e numëron nga dy herë secilin grumbull me nga 25 fletëvotime. Sapo grumbulli të numërohet dy herë, kryesuesi i EN-së do t'i shënojë numrat e përgjithshëm të përfituar në Pjesën IV të fletës së punës së FPR-së përkatëse. Fletëvotimet për atë SP, në grumbuj me nga 25 fletëvotime, kthehen te hapësira e rezervuar për të.

Mbi të vendoset pusulla ku shënohet numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të numëruara për të (kjo u mundëson vëzhguesve të akredituar që t'i shohin shumatat e përgjithshme të numëruara).


**SHËNIM:** Nëse për një subjekt të caktuar politik nuk është hedhur asnjë votë, shënoni zero në hapësirën e caktuar për numrin e votave të fituara, dhe vetëm atëherë kaloni te grumbulli i subjektit politik pasues.

Ky proces përsëritet për secilin SP, duke ndjekur rendin në të cilin subjektet politike figurojnë në fletëvotim, deri sa të numërohen të gjithë grumbujt me fletëvotime për të gjitha SP-të dhe shumatat e përgjithshme të tyre të shënohen në fletën e punës të FPR-së (pjesa IV). Në fund, numri i përgjithshëm i të gjitha votave të vlefshme shënohet në rubrikën 10.

**Kryesuesi i EN-së: Kontrollon dy herë se a janë shënuar numrat e përgjithshëm në rreshtin e saktë që përkon me subjektin politik përkatës!**

## LLOGARITJA E VOTAVE TË KANDIDATËVE TË VEÇANTË PËR ÇDO SUBJEKT POLITIK (SP)

Hapësira për numërim do të përgatitet si më poshtë:



Secilit regjistruer do t'i sigurohen fletët llogaritëse të kandidatit. Çdo **e dhënë** në fletën llogaritëse të kandidatit do të shkruhet **vetëm me stilolaps të kuq**.

Secili lexues do të ketë nga një grumbull me 25 fletëvotime. Lexuesit lexojnë me radhë (një nga një).

Grumbulli që tanimë është numëruar dy herë i SP-së së parë vihet para lexuesit të parë. Tani, ai/ajo fillon të lexojë me zë të lartë numrat e kandidatëve që kanë fituar vota. Nëse janë shënuar më shumë se 10 kandidatë, atëherë lexohen me zë të lartë vetëm 10 kandidatët e parë që kanë fituar vota. Të dy regjistruerit do t'i shënojnë votat për secilin kandidat në fletët llogaritëse të kandidatëve të tyre përkatës (shih fotografinë më poshtë). Pasi lexuesi 1 ta kryejë leximin e grumbullit të tij/saj me 25 fletëvotime, kryesuesi i EN-së e verifikon nëse përputhen fletët llogaritëse. Nëse jo, grumbulli me 25 fletëvotime llogaritet edhe një herë, ndërsa leximin e bën lexuesi 2.

Tani, procesi përsëritet në të njëjtën mënyrë me grumbullin e dytë me 25 fletëvotime dhe leximin e bën lexuesi 2. Nëse një kandidat ka fituar më shumë se 200 vota, përdoret një komplet shtesë i fletës llogaritëse të kandidatit.

Pasi të jenë lexuar, shënuar dhe verifikuar votat në të gjitha fletëvotimet për një SP të caktuar, kryesuesi i EN-së i mbledh votat e fituara nga secili kandidat gjegjës. Kryesuesi i EN-së i shënon shumat e përgjithshme të kandidatëve gjegjës në fletët e rezultatit të kandidatëve dhe i kontrollon duke i krahasuar edhe një herë me përmbledhjen e shumave të përgjithshme.

### Si të vendoset për votat e kandidatëve:

- Nëse në një fletëvotim janë shënuar më shumë se dhjetë (10) kandidatë, do të shënohen vetëm dhjetë (10) preferencat e para. Filloni numërimin nga kandidati i parë që është në krye sipas rendit numerik drejt atyre te posht.
- Nëse në një fletëvotim janë shënuar më pak se dhjetë (10) preferenca, në fletën llogaritëse shënohen vetëm preferencat e shënuara.
- Nëse votuesi nuk ka shënuar asnjë kandidatë për atë SP, atëherë regjistruerit nuk do të shënojnë asgjë në fletën llogaritëse.

**Për secilin SP, llogaritja e votave të kandidatëve në fletën llogaritëse bëhet ashtu siç u përshkrua më lart. Secila fletë llogaritëse e kandidatit do të nënshkruhet nga anëtari i ekipit të numërimit i cili e plotëson atë.**

### Tally Sheet for Kosovo Assembly Elections

Number and Name of Political Entity: 07/ PARTY TENIS

Candidate #	Stack of 25 ballots	Total	Stack of 25 ballots	Total	Stack of 25 ballots	Total	Stack of 25 ballots	Total	Stack of 25 ballots	Total	Stack of 25 ballots	Total	Stack of 25 ballots	Total	Stack of 25 ballots	Total	Grand Total
1	I	1	III	5													6
2																	
3	IIII	6	II	2	IIII IIII IIII	15	IIII IIII	10									28
4																	
5	IIII	5	III	3	IIII IIII	10	III	3	IIII IIII IIII	15	III	3	IIII IIII IIII	15			54
6																	
7	IIII IIII	10	IIII IIII IIII	15	IIII IIII IIII IIII	14											39
8																	
9	III	3	IIII IIII	10	III	3	IIII IIII IIII	15	II	2	IIII IIII	7					40
10																	
11																	
12																	
13	IIII IIII	7	IIII IIII IIII	12	I	1	IIII	5	IIII IIII IIII IIII	15	IIII	5					45
14																	
15																	
16																	
17																	
18																	
19																	
20																	
21																	
22																	
23																	
24																	
25																	
26																	
27																	
28																	
29																	

**Shënim:**

Numri me të cilin shënohet subjekti politik është i njëjtë me atë që paraqitet në fletëvotim.

Filloni llogaritjen e votave të kandidatëve të subjekteve politike me të njëjtën renditje ashtu siç paraqiten në fletëvotim.

Pas përfundimit të llogaritjes së votave të kandidatëve të të gjitha subjekteve politike, renditni fletët llogaritëse të kandidatëve sipas renditjes së SP-ve në fletëvotim.

Bartni shumat e përgjithshme të fletëve llogaritëse të kandidatëve në formularin e rezultatit të kandidatëve në renditjen e përshtuar më lartë.

## **PLOTËSIMI I FLETËS SË PUNËS TË FPR-SË DHE PASTRIMI I TAVOLINËS PAS PËRFUNDIMIT TË NUMËRIMIT PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E KOSOVËS:**

- ✓ Të gjitha **fletëvotimet e zbrazëta** numërohen dy herë dhe shuma e përgjithshme shënohet në rubrikën 11 të fletës së punës të FPR-së. Ato lidhen me spango dhe vendosen në **zarfin 3**.
- ✓ Të gjitha **fletëvotimet e pavlefshme** (duke përfshirë edhe **fletëvotimet e pavulosura**) numërohen dy herë dhe shuma e përgjithshme shënohet në rubrikën 12 të fletës së punës të FPR-së. Ato lidhen me spango dhe vendosen në **zarfin 3**, së bashku me fletëvotimet e zbrazëta.
- ✓ Shuma e përgjithshme e të gjitha **fletëvotimeve të vlefshme** shënohet në rubrikën 13 të fletës së punës të FPR-së. **Fletëvotimet e vlefshme të secilit SP** palosen dy herë, lidhen me spango dhe vendosen në **thesin 4**.
